

İsa SÜLÇEVSI*

DISA VEÇORI PËR ORTOGRAFINË NË GJUHËN TURKE TË TOPONIMEVE NË KOSOVË

Fjala toponim nënkupton “emër vendi (krahine, qyteti, fshati, lumi, përroi, deti, liqeni, mali, are etj.)”¹. Sipas Këshillit Ndërkombëtar të Termave të Onomastikës, nëse toponimet janë të kufizuara me planetin e tokës, këto mund të emërtohen edhe si “emra gjeografik”². Pra emërtimet e vendbanimeve, janë njëri nga objektet e toponimisë, gjegjësisht janë një lloj emri gjeografik; por jo vetëm kaq.

Vendbanimet janë edhe objekt i historisë, kur bëhet fjalë për vendin e ndodhjes së një ngjarjeje historike; edhe i letërsisë, si element i rëndësishëm i prozës, por edhe i poezisë, kur një poezi apo këngë i kushtohet një vendbanimi. Vendbanimet gjithashtu janë edhe objekt i administratës shtetërore, i adresës së dorëzimit të një dërgese, i adresës së banimit të gjithë neve, i vendndodhjes së një stadiumi, i një salle të koncerteve, i një muzeu të parapëlqyer, i një restoranti me gatime tradicionale, i burimit të një lumi, i vendlindjes së një poeti të madh, i kujtimeve kur për herë të parë ia kemi shprehur dikujt dashurinë etj. Me një fjalë, vendbanimet, respektivisht emrat e tyre, janë një element i rëndësishëm në të gjitha sferat e jetës së njeriut. Një fakt tjetër i cili

* Profesor i gjuhës turke në Degën e Orientalistikës, Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë.

¹ <http://www.fjalori.shkenca.org/>. (04.05.2021).

² “ICOS Lists of Key Onomastic Terms”,
<https://icosweb.net/wp/wp-content/uploads/2019/05/ICOS-Terms-en.pdf>,
(04.05.2021).

mund të merret për bazë për rëndësinë e emërtimeve gjeografike, është edhe Grupi i Ekspertëve për Emërtime Gjeografike që vepron në kuadër të Departamentit për Statistika të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.³ Pra OKB-ja e ka konsideruar të rëndësishme toponiminë, prandaj është formuar një komision i tillë i përhershëm që merret me veprimtari të lidhura me toponiminë. Mu për këtë arsye, emrat e vendbanimeve gjegjësisht toponimet, janë një nëndisiplinë e rëndësishme e onomastikës dhe meritojnë trajtim të gjerë. Në këtë punim është trajtuar vetë aspekti ortografik në gjuhën turke të toponimeve në Kosovë.

Kosova është një shtet me shoqëri shumetnike dhe me dy gjuhë zyrtare në nivel qendror. Ndërsa në nivel lokal gjuha turke, boshnjake dhe rome mund të kenë statusin e gjuhës zyrtare.⁴ Komunitetet jo-shumicë, siç është përcaktuar në nenin 59.9 të Kushtetutës së Kosovës, gëzojnë të drejtën “të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësor të zonës përkatëse”⁵.

Në Kosovë ekziston komuniteti turk, që sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2021, është llogaritur të jenë 18.738 banorë⁶. Sipas regjistrimit në fjalë, në Kosovë në kategorinë “gjuhët e folura të ndryshme nga gjuha amtare sipas gjinisë dhe moshës së popullsisë së moshës 15 vjeçe e mbi”⁷ janë evidentuar të jenë 49.729 folës të gjuhës turke. Pjesëtarët e komunitetit turk dhe folësit tjerë të turqishtes, jetojnë kryesisht në qendra urbane, si Prizreni, Prishtina, Gjiłani, Mitrovica, Vushtrria si dhe, në vendbanimet Mamushë, Dobërçan dhe Janjevë. Turqishtfolësit në Kosovë, në komunikimin e tyre jozyrtar, e përdorin turqishten lokale, e cila sipas studiuesve ndahet në të folmet e Prizrenit-Mamushës,

³ <https://unstats.un.org/unsd/ungegn/> (12.09.2021).

⁴ Neni i 3-të dhe i 5-të i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>. (04.05.2021).

⁵ Op. Cit.

⁶ Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011. <https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf>. f. 60.

⁷ Ibid. f. 67.

Prishtinës-Janjevës, Gjilanit-Dobërçanit, Vushtrrisë, Mitrovicës dhe të Pejës.

Pjesëtarët e komunitetit turk, pas përfundimit të sundimit osman më 1912, deri më 1951, janë shkolluar në gjuhën serbe dhe shqipe. Por, pas njohjes së statusit të kombësisë, me vendimin e Këshillit Popullor të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë⁸, i datës 20 mars 1951, komunitetit turk i është dhënë e drejta e shkollimit në gjuhën amtare. Si rezultat i këtij vendimi në vendbanimet e Kosovës të banuara me turq, gradualisht janë hapur shkollat në gjuhën turke të nivelit parauniversitar. Aktualisht në Kosovë, në 11 shkolla nëntëvjeçare, ekzistojnë paralele të mësimi në gjuhën turke. Këto shkolla me paralele të mësimi në gjuhën turke, 6 janë në Prizren, 1 në Prishtinë, 1 në Mamushë, 1 në Gjilan, 1 në Dobërçan dhe 1 në Mitrovicë. Ndërsa shkollat e mesme të larta në të cilat ekzistojnë paralele të mësimi në gjuhën turke ndodhën në Prizren, Prishtinë, Mamushë dhe në Gjilan.

Veprimtaria botuese në gjuhën turke në Kosovë, daton që nga viti 1970, kur ishte themeluar gazeta “Tan” dhe botimet “Tan”. Në kuadër të botimeve “Tan”, janë botuar revista “Çevren”, revista “Kuş”, lektura shkollore etj. Krahas botimeve “Tan”, në Prizren janë botuar revistat “Esin”, “Bay”, “Türkçem”. Në Prishtinë është botuar edhe revista “Bahar”.

Mediumet elektronike si ish TVP, Radio Prishtina, dhe aktualisht RTK1, kanë emisione në gjuhën turke. Po ashtu aktualisht janë edhe tri portale në gjuhën turke, Kosova Haber, Kosova Port dhe Yeni Tan.

Në gjitha mediumet dhe në shkollat me mësim në gjuhën turke, përdoret gjuha standarde turke.

Në aspektin historik, turqishtja në Kosovë llogaritet ta ketë fillin pas Betejës së Kosovës, më 1389. Ndërsa popullimi turk në Kosovë, sipas burimeve turke, pretendohet të ketë filluar në periudhën e Sulltan

⁸ Gashi, Skënder. *Kërkime onomastike-historike për minoritete të shuara e aktuale të Kosovës*, ASHAK, 2015, f. 725.

Bajezidit I deri në periudhën e Sulltan Mehmetit II.⁹ Por në burimet kosovare një dukuri e tillë mohohet. Sipas Gashit:

Perandoria Osmane, për ndryshim nga ardhësit sllavë, nuk solli me vete popullatë turke për t'i kolonizuar viset e pushtuara dhe se as pas tërheqjes së kësaj perandorie nga tokat e shqiptarëve nuk pati asnjëherë vendosje të popullatës turke në këto hapësira. Ata janë mbetje minimale e turqve nga mesjeta që erdhën si ushtarakë, nëpunës (që e kontrollonin tregtinë me xehe dhe doganat e Kosovës) e ndoshta edhe si zanatlinj të vendosur fillimisht në kështjella të rëndësishme, përkatësisht në qytete. Shumica e turqve janë në të vërtetë shqiptarë të turqizuar.¹⁰

Sidoqoftë, në Kosovë ekziston një komunitet turk, i cili edhe në bazë të statusit kushtetues por edhe për nga tradita shekullore është pjesë e barabartë e shoqërisë kosovare. Si rezultat i pushtetit disa shekullore i perandorisë osmane, në gjitha sferat e shoqërisë, kulturës, traditës, gjuhës, folklorit, letërsisë etj. ekziston një ndikim turk. Por edhe gjuha, kultura, tradita, folklori, letërsia turke është pasuruar me elemente të popujve tjerë, me të cilët ka qenë në kontakt. Në këtë kontekst gjuha turke në aspektin toponimik është pasuruar nga toponimet e vendeve të sunduara nga Perandoria osmane.

Shteti osman në vendet që ka vënë nën administrimin e vetë, nuk e ka praktikuar ndryshimin e toponimeve. Në shumicën e rasteve janë ruajtur toponimet ekzistuese por duke ia përshtatur sistemit fonetik të gjuhës turke. Sa për të ilustruar një qëndrim të tillë do ti përmendim disa shembuj. Emërtimi Stamboll (İstanbul) rrjedh nga fjala greke ‘stin póli’ (στην πόλι), që nënkupton “qendra e qytetit”.¹¹ Toponimi Edrene

⁹ Münir Aktepe, “XIV. ve XV. Asırlarda Rumeli’nin Türkler Tarafından İskanına Dair”, *Türkiyat Mecmuası*, C. 10, 2010, s. 299–312; Mehmet İnbaşı, “Balkanlar’da Osmanlı Hakimiyeti ve İskan Siyaseti”, C. C. 9, ed. Hasan Celal Güzel, Kemal Çiçek, Salim Koca, *Türkler Ansiklopedisi*, Yeni Türkiye Yayınları, 2002.

¹⁰ Gashi, Skënder. *Kërkime onomastike...*, f. 724.

¹¹ <https://www.nisanyansozluk.com/?k=%C4%B0stanbul>
Qasja më: 10.09.2021.

(Edirne) gjithashtu buron nga emërtimi grek Hadrianopolis (Ἀδριανούπολις).¹² Ngjashëm edhe emërtimin në gjuhën turke i Pllovdivit në Bullgari, është Filibe, fjalë kjo që rrjedh nga Filippolis (Philipopolis /Φιλιππούπολις/).

Siç mund të kuptohet nga shembujt e dhënë toponimet në Perandorinë osmane janë ruajtur, por me përshtatje fonetike, gjë që ndodhë në shumicën e gjuhëve. Edhe toponimet İpek (Pejë), Priştine (Prishtinë), Mitroviça (Mitrovicë), Viçitrin (Vuçitrin /Vushtrri/), Görice (Korçë /Κορυτσά/¹³), İşkodra (Shkodër), Ülgün (Ulqin), Ergiri (Gjirokasta /Αργυρόκαστρο/¹⁴) janë produkt i mënyrës së njëjtë të formimit.

Ndërsa toponimet (Ferizaj), Kurşunlu (Kurshumli), Taşlıca (Plevlë), Akçahisar (Krujë) janë toponime të prodhuara nga administrata osmane.

Këto emërtime gjeografike vazhdojnë të përdoren me format e tyre të vjetra, edhe pse një numër i tyre për shqipfolësit konsiderohen si emërtime historike pra, arkaike.

Perandoria osmane përmes shënimeve për popullsinë, shënimeve për timare e shënime tjera të ngjashme, që në shumicën e rasteve emërtohen “defter”, ka arritur të ndërtojë një bazë të mirë të të dhënave sa i përket toponimeve. Është një botim i Arkivave Shtetërore të Turqisë për toponimet osmane, ku janë të përfshira 8.710 toponime të perandorisë osmane.¹⁵ Natyrisht që ky regjistër nuk është gjithëpërfshirës, por sa i përket vendbanime urbane ofron informata të bollshme.

Ekzistojnë edhe vjetarët që quhen “Sallname”, të cilët fillojnë të botohen nga organet shtetërore të Perandorisë Osmane, ndërmjet viteve

¹² <https://en.wikipedia.org/wiki/Edirne>
Qasja më: 10.09.2021.

¹³ <https://tr.wikipedia.org/wiki/G%C3%B6rice>
Qasja më: 10.09.2021.

¹⁴ <https://tr.wikipedia.org/wiki/Ergiri>
Qasja më: 10.09.2021.

¹⁵ Tahir Sezen, *Osmanlı Yer Adları*, T.C. Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Ankara, 2017.

1847-1922. Sallnamet e vilajeteve botohen nga viti 1866, që vjetari i parë i kësaj natyre është “Salnâme-i Vilâyet-i Bosna” i botuar në Sarajevë.¹⁶ Ndërsa *sallnamet e vilajetit të Kosovës* botohen gjithsej 8 numra. Pesë numrat e parë në Prishtinë, më 1879 deri më 1888; ndërsa të tjerët në Shkup, pasi që shtypshkronja e vilajetit transferohet në Shkup në vitin 1893, dhe numri i fundit i sallnames së Kosovës është botuar më 1900. Një sallname tjetër që ka të bëjë me Kosovën, është Sallnameja e vilajetit të Prizrenit, e botuar në dy numra më 1873 dhe 1874.¹⁷ Në sallnamet në fjalë jepen edhe toponimet e vendbanimeve më të vogla dhe që nuk janë përfshirë në veprën Toponimet osmane (Osmanlı Yer Adları). Duke marrë parasysh këtë fakt mund të konkludohet se shumica e vendbanimeve aktuale janë të evidentuara në burimet osmane në pjesën e dytë të shekullit XIX. Prandaj kjo mund të konsiderohet një bazë e mirë e të dhënave për format në gjuhën turke të toponimeve në Kosovë.

Pjesëtarët e komunitetit turk në Kosovë në komunikimin privat por edhe në atë zyrtar në gjuhën turke, i përdorin toponimet me formën e tyre tradicionale të trashëguara nga periudha osmane. Një përdorim i tillë më shumë lidhet me vendbanimet që turqit e Kosovës vazhdojnë të kultivojnë gjuhën dhe kulturën e tyre. Këto vendbanime janë Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Gjilani, Vushtrria, Mamusha dhe Dobërçani. Ekzistojnë edhe disa vendbanime më të cilët kanë lidhje farefisnore, kulturore e historike. Këto janë: Peja, Gjakova, Janjeva, Rahoveci, Dragashi, Novobërda, Gora (si rajon gjeografik) etj. Pra, në përditshmërinë e tyre turqit e Kosovës janë të familjarizuar me këto vendbanime dhe i përdorin format në gjuhën turke, por jo të gjitha si në shënimet osmane. P.sh. emërtimi gjeografik për Vushtrrinë, nga turqit e Kosovës përdorët në formën tashmë tradicionale në nivel lokal, që

¹⁶ Bilgin Aydın, "Salnâme", TDV İslâm Ansiklopedisi, <https://islamansiklopedisi.org.tr/sallname> (11.09.2021).

¹⁷ İSAM Kütüphanesi Osmanlı Salnâmeleri Veri Tabanı] <http://ktp.isam.org.tr/> (11.09.2021)

është Viçitrin (Vëçëtërën). Ndërsa në burimet osmane ky toponim shënohet si Vulçitrin respektivisht Vulçitrin.¹⁸ Së këndejmi toponimi Janjevë, nga turqit e Kosovës shqiptohet si Yanava ose Yanyeva. Ndërsa patronimi (mbiemri) që derivon nga ky toponim është Yanova. Në burimet osmane ky toponim është shënuar si Yanova.

Janë disa toponime që për to janë krijuar format tradicionale në gjuhën turke, mund të kenë përdorime të pastandardizuara. Bie fjala për Graçanicë (Gračanica), Viti (Vitina), Ujman (Gazivodë/Gazivoda), Suharekë (Suva Reka).

Deri në këtë pjesë bëme përpjekje të përshkruajmë disa tipare të varianteve në gjuhën turke të toponimeve kosovare. Bazuar në këtë që u parashtua deri më tani, variantet në gjuhën turke të toponimeve në Kosovë mund ti ndajmë në këto lloje:

- toponime me forma tradicionale që vazhdojnë të përdoren në shkrim dhe në bisedë nga turqishtfolësit e Kosovës,
- toponime me forma tradicionale që vazhdojnë të përdoren në shkrim nga turqishtfolësit e Kosovës, por që në bisedë përdoren forma tjera,
- toponime që nuk kanë forma tradicionale, por që në bisedë përdoren në format e tyre në njërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë.

Siç u tha edhe më lart, toponimet janë objekt i sferave të ndryshme të jetës. Prandaj drejtshkrimi i tyre ka rëndësi. Por cili mund të jetë kriteri që këta emra të shënohen saktë? Për këtë pyetje nuk ekziston një përgjigje e vetme e saktë. Përse nuk ekziston një përgjigje e vetme e saktë? Sepse komuniteti turk në Kosovë në aspektin juridik i gëzon disa të drejta kushtetuese për përdorimin e gjuhës amtare dhe të shkrimit të gjuhës; në aspektin historik konsiderohet vendas i Kosovës dhe

¹⁸ Muhammed Aruçi, "Vulçitrin", TDV İslâm Ansiklopedisi, <https://islamansiklopedisi.org.tr/vulcitrin> (11.09.2021).

tashmë ka krijuar një trashëgimi gjuhësore, kulturore, folklorike, letrare etj.

Me gjithë faktin se e drejta kushtetuese e siguar me nenin 59.9 të Kushtetutës së Kosovës që mundëson përdorimin e “emërtimeve lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë”, në praktikë po vërehet një laramani në përdorimin e toponimeve si Viçitirin/Vuștri, Vitina/Viti, Cakova/Yakova, Yanava/Yanova. Në bisedë edhe pse nuk çon peshë cila formë do të përdoret, pasi që turqit e Kosovës në i përdorin varietetet e tyre lokale, por në komunikim zyrtar, p.sh. në tekste shkollore, në certifikata të lindjes, në letërnjoftime që lëshohen nga organet e Kosovës, drejtshkrimi i tyre ka rëndësi të veçantë dhe duhet të jetë i standardizuar. Edhe pse pjesëtarët e komunitetit turk të Kosovës kanë të drejtë të pajisjen me dokumente në gjuhën turke nga shërbimi civil në Kosovë, në përjashtim të disa vendbanimeve, nuk është përcaktuar ndonjë standard për drejtshkrimin e tyre. Por jo vetëm kaq, edhe në tekste të karaktereve të ndryshme ekziston një mjegullinë në përdorimin e tyre. P.sh. para disa kohësh një student i Fakultetit të Filologjisë në UP, kishte paraqitur kërkesë për një temë diplome në të cilën përdorej emërtimi Vuștri. Në Kosovë gjuha e parë zyrtare është shqipja, dhe emërtimi i zyrtar në shqip është “Vushtrri”, por në gjuhën turke medoemos nuk duhet të jetë kështu.

Ndryshimet e emrave të vendbanimeve bëhen me vendime të organeve të caktuara. Një dukuri e tillë ekziston në gjithë botë. Është e ditur se Shën Petersburgu në Rusi, një periudhë është emërtuar Leningrad, por edhe Petrograd.¹⁹ Por ndryshimet e emrit të këtij qyteti janë bërë me vendim të një organi legjitim e të pranueshëm edhe në nivel kombëtar e madje në nivel ndërkombëtar.

Ndërsa në rastin e Vushtrrisë, ndryshimi i emërimit zyrtar nga Vuçitërna në Vushtrri, nuk është paraparë që të implikojë edhe përdorimin në gjuhën turke.

¹⁹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Sh%C3%ABn_Petersburgu (11.09.2021)

Si të veprohet në këso raste?

Për drejtshkrimin dhe përdorimin oral të toponimeve në fjalë, mund të sugjerohen zgjidhjet në vijim.

- *Toponimet me forma tradicionale që vazhdojnë të përdoren në shkrim dhe në bisedë nga turqishtfolësit e Kosovës:*

Toponimet për të cilat turqishtfolësit kosovarë kanë krijuar forma tradicionale dhe që nuk përmbajnë fonema të cilat nuk i posedon turqishtja, edhe në shkrim edhe në bisedë të përdoret versioni i turqishtfolësve lokalë. Ta zëmë, për një vendbanim në komunën e Prizrenit, të përdoret versioni i turqishtfolësve nga Prizreni. Nëse për një toponim ekzistojnë edhe burime të shkruara nga turqishtfolësit kosovarë, p.sh. gazeta “Tan”, mund të zgjidhet forma e shkruar që tashmë përdoret tradicionalisht. Këtu mund të përmendët shembulli Yanova/Yanava. Disa prishtinas e përdorin trajtën “Yanava”, por në dokumente të shkruara përdoret forma “Yanova”.

- *Toponimet me forma tradicionale që vazhdojnë të përdoren në shkrim nga turqishtfolësit e Kosovës, por që në bisedë përdorën forma tjera:*

Në këtë grup të toponimeve bëjnë pjesë *Cakova/Yakova*, *Mitrovitsa/Mitroviça*. Në rastin e Gjakovës edhe pse në shkrim përdoret trajta “Yakova”, në biseda private turqishtfolësit kosovarë e përdorin formën “Cakova” (Xhakova). Pra në shkrim duhet respektuar formën “Yakova” (Jakova). Ndërsa te rasti Mitrovitsa (Mitrovica) përdoret fonema “c” të cilën nuk e ka gjuha turke. Turqishtfolësit lokal pa problem e artikulojnë këtë fonemë dhe toponimet që përmbajnë këtë fonemë nuk i ndryshojnë. Por edhe në tekste të shkruara në nivel lokal, si dhe në tekste të periudhës osmane, fonema “c” zëvendësohet me fonemën, respektivisht me shkronjën “ç” dhe toponimi e merr trajtën “Mitroviça”. Bile në burimet osmane ky toponim shënohet si “Mitroviçe”, por këtë formë duhet trajtuar si formë historike që nuk ka pasur përdorim të pandërprerë tek turqit lokal.

- *Toponimet që nuk kanë forma tradicionale, por që në bisedë përdoren në format e tyre në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë:*

Turqit e Kosovës në shumicën e rasteve jetojnë në qendra urbane. Nëpër qytezat e Kosovës nuk ka turqishtfolës burimorë. Madje, në përjashtim të rasteve të mundshme individuale, me disa qyteza nuk kanë as lidhje farefisnore, historike, socio-kulturore apo edhe ekonomike. Për këtë arsye nuk kanë krijuar forma tradicionale të toponimeve. Në këtë grup mund t'i numërojmë vendbanimet Skenderaj, Drenas/Glllogoc, Istog, Kamenicë, Podujevë etj. Edhe pse disa prej këtyre toponimeve mund të gjinden në burime osmane, për drejtshkrimin e këtyre toponimeve duhet të praktikohen rregullat e drejtshkrimit të Institutit të Gjuhës Turke (Türk Dil Kurumu). Drejtshkrimori i gjuhës turke për drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj parasheh disa rregulla.²⁰ Këto rregulla lidhen me alfabetin që përdoret në gjuhën gjegjëse dhe me huazimin e formave tradicionale të disa emrave të përveçëm nga gjuhët që përdorin alfabetin latin. Ndërsa për emrat e përveçëm nga gjuhët që përdorin alfabetet tjera, vlen rregulli i shqiptimit nga turqishtfolësit.

Pra në rastin e toponimeve të shënuara më lart, vlen rregulli i grafisë origjinale, por me përjashtim të shenjave diakritike që nuk i përmban alfabeti turk. Nga shkronjat e alfabetit të shqipes me shenja diakritike që nuk i ka alfabeti turk, është vetëm shkronja “ë”. Edhe pse turqishtja nuk i ka shkronjat *w*, *q*, *x*, për shkrimin e emrave të përveçëm të huaj të gjuhëve që përdorin alfabetin latin, këto shkronja përdoren. P.sh. *New York*, *Wupperal* etj. Pra, vendbanimet *Skenderaj*, *Podujevë*, *Kamenicë*, në përdorimin e tyre në gjuhën turke duhej të shkruheshin si; *Skenderaj*, *Podujeve*, *Kamenice*.

Disa toponime forma e të cilave në gjuhën turke për nga aspekti fonemik dukshëm dallon nga forma në gjuhën shqipe, si në rastin İpek

²⁰ <https://www.tdk.gov.tr/icerik/yazim-kurallari/yabanci-ozel-adlarin-yazilisi/>
(11.09.2021)

(Pejë), në përkthime të dokumenteve zyrtare, si: dokumente të gjendjes civile, akte noteriale, dokumente gjyqësore dhe kadastrale, mirë është të shkruhen bashkë me grafina origjinale në kllapa.

Këto sugjerime vlejné për përdorim në tekste të komunikimit masiv, tekste për informimin e opinionit të gjerë, tekste shkollore dhe dokumente zyrtare. Ndërsa në tekste letrare mund të mos përfillën. Por, për përdorim në dokumente zyrtare mund të rekomandohet hartimi i një liste të vendbanimeve të Kosovës me forma të standardizuara në gjitha gjuhët në të cilat lëshohen dokumentet zyrtare të shërbimit civil, si: certifikata e lindjes, e martesës, e statusit civil etj. por edhe dokumente tjerë pedagogjikë, të regjistrit kadastral dhe të organeve të gjyqësorisë.

Si përfundim, toponimet shpeshherë kanë forma të ndryshme fonemike në gjuhë të ndryshme; si në rastin e Kosovës, ku janë më shumë se një gjuhë zyrtare dhe përdoren më shumë se një alfabet zyrtar. Në këso raste emërtimet gjeografike, në këtë kontekst edhe toponimet, kërkojnë një trajtim të standardizuar, me ç'rast për një standardizim të tillë iniciativa i takon organeve shtetërore por në bashkëpunim me ekspertë të gjuhësisë. Në Kosovë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ekziston Zyra për Çështje të Komuniteteve²¹, zyrë kjo e cila është përpunuese e merret me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet, por në shikim të parë të ueb faqes së saj të krijohet përshtypja se kjo zyrë nuk i është dedikuar të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë por vetëm komunitetit serb. Kjo për arsye se në faqen kryesore të ueb faqes në fjalë paraqiten gjuha shqipe, gjuha serbe me alfabetë (latin dhe cirilik) dhe gjuha angleze. Pra, çështja e standardizimit të emërtimeve gjeografike në mbarë Kosovën, edhe pse është shumë e nevojshme për arsyet e parashtruara më lart, aktualisht mund të jetë vetëm një dëshirë e mirë, por jo edhe shumë e mundshme.

²¹ <https://zck-ks.net> (12.09.2021).

Burimet:

1. Başkan, Özcan, *Bildirişim – İnsan Dili ve Ötesi*, Multilingual, 2003 İstanbul.
2. Gashi, Skënder. Kërkime onomastike-historike për minoritete të shuara e aktuale të Kosovës, ASHAK, 2015.
3. Kosova Vilayeti Salnamesi 1896, Rumeli Türkleri Kültür ve Dayanışma Derneği Yayınları, 2000 İstanbul
4. Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti, T.C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, 2007 İstanbul
5. Mehmet İnbaşı, “Balkanlar’da Osmanlı Hakimiyeti ve İskan Siyaseti”, C. C. 9, ed. Hasan Celal Güzel, Kemal Çiçek, Salim Koca, Türkler Ansiklopedisi, Yeni Türkiye Yayınları, 2002.
6. Tahir Sezen, Osmanlı Yer Adları, T.C. Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Ankara, 2017.
7. Münir Aktepe, “XIV. ve XV. Asırlarda Rumeli’nin Türkler Tarafından İskanına Dair”, *Türkiyat Mecmuası*, C. 10, 2010, s. 299-312.

Burimet elektronike

1. Bilgin Aydın, "Salnâme", TDV İslâm Ansiklopedisi, <https://islamansiklopedisi.org.tr/salname> . (11.09.2021).
2. <http://unstats.un.org/unsd/geoinfo/geog%20names%20final.pdf> (13.02.2011)
3. <http://www.fjalori.shkenca.org/>. (04.05.2021).
4. <https://en.wikipedia.org/wiki/Edirne> (10.09.2021).
5. https://sq.wikipedia.org/wiki/Sh%C3%ABn_Petersburgu. (11.09.2021).
6. <https://tr.wikipedia.org/wiki/Ergiri> (10.09.2021).
7. <https://tr.wikipedia.org/wiki/G%C3%B6rice> (10.09.2021).
8. <https://unstats.un.org/unsd/uneggn/> (12.09.2021).
9. <https://www.nisanyansozluk.com/?k=%C4%B0stanbul> (10.09.2021).

10. <https://www.tdk.gov.tr/icerik/yazim-kurallari/yabanci-ozel-adlarin-yazilisi/> (11.09.2021)
11. <https://zck-ks.net> (12.09.2021).
12. "ICOS Lists of Key Onomastic Terms", <https://icosweb.net/wp/wp-content/uploads/2019/05/ICOS-Terms-en.pdf>. (04.05.2021).
13. İSAM Kütüphanesi Osmanlı Salnâmeleri Veri Tabanı] <http://ktp.isam.org.tr/> (11.09.2021)
14. Muhammed Aruçi, "Vulçitrin", TDV İslâm Ansiklopedisi, <https://islamansiklopedisi.org.tr/vulcitrin>. (11.09.2021).
15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>. (04.05.2021)
16. Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011. <https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf>. (04.05.2021)

